



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË

Numri i lëndës: 2024:047854
Datë: 01.11.2024
Numri i dokumentit: 06387613

C.nr.3600/23

GJYKATA THEMELORE NE GJAKOVË - Departamenti i Përgjithshëm, Gjyqtarja Blerina KURTAJ, me bashkëpunëtoren profesionale Gresa Haxhiavdyli duke vendosur në çështjen juridike kontestimore të paditëses A.B. nga Gjakova, të cilën me autorizim e përfaqëson Kastriot Feka, avokat në Prishtinë, Rr. "Fehmi Agani" 36/4-Prishtinë, kundër të paditurit Shërbimi Spitalor dhe Klinik Universitar i Kosovës – Spitali i Përgjithshëm "Isa Grezda" në Gjakovë, të cilin me autorizim e përfaqëson Valdete Rudi – juriste, me objekt kontesti: kompensim i pagës se 13-të dhe kompensim i ushqimit në punë, jashtë seancës, me 01 nëntor 2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

I. REFUZOHET në tërësi e pabazuar kërkesëpadia e paditëses A.B. nga Gjakova, me të cilën ka kërkuar që të detyrohet i padituri Shërbimi Spitalor dhe Klinik Universitar i Kosovës – Spitali i Përgjithshëm "Isa Grezda" në Gjakovë, që në emër të pagës së 13 (trembëdhjetë), për vitin 2021 dhe 2022, t'ia paguaj shumën prej 942.00 euro, si dhe në emër të kompensimit të ushqimit në punë t'ia paguaj shumën prej 732.16 euro, me kamatë prej 8% nga data e paraqitjes së padisë e deri në pagesën definitive, në afatin prej 7 ditësh nga dita e marrjes së aktgjykimit, nën kërcënim të përmbarimit.

II. Secila palë i bartë shpenzimet e veta të procedurës.

A r s y e t i m

Paditësja përmes të autorizuarit të saj me datë 29.12.2023, në këtë gjykatë ka parashtruar padi të cilën e ka precizuar me datë 26.06.2024, në të cilën ka theksuar se paditësja është në marrëdhënie të punës se rregullt të e paditura, me kontratë në kohë të pacaktuar me detyrat e punës si

Infermiere kryesore në Repartin e Ortopedisë. Ka shtuar se paditësi në bazë të listës se pagave, e lëshuar nga Buxheti i Republikës së Kosovës, në vitin 2021 e ka pasur pagën bazë në shumë prej 471.00 euro, në vitin 2022, e ka pasur pagën bazë në shumë prej 471.00 euro. Ka theksuar se prej datës 06.02.2023 ka hyre në fuqi Ligji nr.08/L196 për Paga në Sektorin Publik duke theksuar se paditësit nuk i është kompensuar fare për shtesën në emër të shujtave ditore ashtu siç parashihet me Deklaratën e përbashkët të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Federatës Sindikale të Shëndetësisë së Kosovës, të datës 14.10.2008. Tutje ka theksuar se në nenin 17 paragrafi 2 të Kontratës Kolektive Sektoriale të shëndetësisë e nënshkruar nga Ministria e Shëndetësisë së Republikës së Kosovës dhe Federatës së Sindikatave të Shëndetësisë së Kosovës, parashihet se “Punëmarrësi ka të drejtë në kompensimin e pagës se 13 (trembëdhjetë) për çdo vit kalendarik, në vlerën e pagës bazë, sipas mundësive buxhetore të punëdhënësit”, e që dispozita e paracituar duhet interpretuar në atë mënyrë që e drejta për realizimin e pagës se 13 lind kur punëdhënësi nuk e përmbush atë, ndërsa në asnjë mënyrë e paditura nuk arrin të provoj se nuk ka pasur mundësi buxhetore, ku kjo është thënë edhe në mendimin e Gjykatës Supreme të Kosovës, për zbatimin e kontratës kolektive sektoriale lidhur me kërkesat e pagës se 13 në sektorin e shëndetësisë, 212/2023, të datës 09.10.2023. Me propozim për gjykatën që ta aprovoj kërkesëpadinë e paditëses, ashtu që ta detyroj të paditurin në pagimin e shumës prej 942.00 euro në emër të pagës se 13, për vitin 2021 dhe 2022, dhe në emër të shujtave ditore në punë shumë prej 732.16 euro, me kamatë prej 8%, e cila do të llogaritet nga data e paraqitjes së padisë e deri në pagesën definitive, nën kërcenim të përmbaramit.

E paditura, përmes të autorizuarës së saj me datë 19.03.2024, në këtë gjykatë ka paraqitur përgjigje në padi, në të cilën ka theksuar se e kundërshtojmë kërkesëpadinë e paditëses si të pabazuar, të parashkruar dhe të pathemeltë. Tutje ka parashtruar se padisë së paditëses i mungon baza ligjore, pasi që bëhet fjalë për kontratën kolektive sektoriale të shëndetësisë, e cila ka qenë në fuqi nga data 11.06.2018 e deri me datë 10.06.2021. Ka theksuar se sipas dispozitës së nenit 17 paragrafi 2 të KKS-së, e njëjta interpretohet duke u lidhur me ekzistimin e mundësisë për një shpërblim të tillë, siç ka paraparë edhe Gjykata Supreme e Kosovës në mendimin juridik me numër protokollit 212/2023, të datës 09.10.2023, andaj edhe i padituri SHSKUK si organizatë buxhetore ka pasur mungesë të buxhetit nder vite në kategoritë e pagave dhe mëditjeve, edhe përkundër planifikimeve, i njëjti asnjëherë nuk ka pasur buxhet të mjaftueshëm për të plotësuar nevojat në paga dhe mëditje, ku në tremujorin e fundit TM3 të çdo viti, vazhdimisht ka pasur deficit në paga dhe është plotësuar nga Ministria e Financave për mbulimin e pagave të rregullta, siç provohet edhe nga njoftimi i lëshuar nga Drejtori Financiar i SHSKUK z. Enver Gashi, me

numër protokolli 3823, i datës 21.12.2023. Po ashtu, ka parashtruar se edhe Spitali i Përgjithshëm “Isa Grezda” në Gjakovë, si institucion shëndetësor i nivelit sekondar/dytësor nuk ka mundësi buxhetore të bëjë kompensimin e shpërblimit për pagën e 13, siç provohet edhe nga përgjigja në kërkesë me numër protokolli 3610, e datës 13.12.2023, e lëshuar nga U. D. i shefit të njësisë për buxhet dhe financa z. Murat Kursani. Me propozim për gjykatën që ta refuzoj kërkesëpadinë e paditësit si të pabazuar.

Gjykata, pas shqyrtimit të padisë, provave që gjenden në shkresat e lëndës, si dhe përgjigjes në padi, në kuptim të nenit 399 i Ligjit për Procedurën Kontestimore (në tekstin e mëtutjeshëm LPK) erdhi në përfundim se kërkesëpadia e paditësit është në tërësi e pabazuar për arsyet si në vijim:

Në mes të palëve nuk ishte kontestues fakti se paditësi është i punësuar tek i padituri, përkatësisht në punët dhe detyrat si Infermiere kryesore në Repartin e Ortopedisë, po ashtu nuk ishte kontestues se e njëjta realizon pagë mujore bazë prej 471.00 euro.

Kontestuese në këtë rast në mes palëve ishte se a i takon paditësit e drejta për kompensimin e pagës së 13 a ekzistojnë mundësitë buxhetore të te paditurit për pagimin e pagës së 13, kundrejt paditësit si dhe kompensimit të ushqimit në punë.

Sa i përket pjesës së kërkesës për pagesën e pagës së 13-të për vitet kalendarike 2021 dhe 2022, gjykata konstaton se bazuar në faktin se Kontratës Kolektive Sektoriale të Shëndetësisë mbi bazën e së cilës pala paditëse e mbështetë themelësinë e kërkesëpadisë i ka skaduar afati i vlefshmërisë me datë 10.06.2021, andaj rezulton se e njëjta ka pushuar të prodhojë efekt juridik. Në këtë kuptim, punëtorët shëndetësorë nuk mund t'i gëzojnë beneficionet e përcaktuara me dispozitat e kësaj Kontrate pas skadimit të afatit të vlefshmërisë së të njëjtës, përfshirë edhe të drejtën e kompensimit të pagës së 13-të për vitet kalendarike 2021 dhe 2022. Si rezultat i një interpretimi të tillë, Gjykata vlerëson se palës paditëse i mungon baza ligjore e mbështetjes së kërkesëpadisë në këtë çështje juridike, respektivisht mbështetja e bazës juridike në një akt juridik të cilit i ka skaduar afati i vlefshmërisë, paraqet fakt i cili është qartazi në kundërtënie me një fakt që Gjykata e konsideron të njohur, përkatësisht referuar aplikueshmerisë se Kontratës Kolektive Sektoriale të Shëndetësisë të datës 12.06.2018, kjo gjykatë erdhi në përfundim se në kohën kur ka lindur e drejta e paditësit për të kërkuar një të drejtë të cilën mendon se i takon,

kontrata e cekur si me lartë nuk ka qenë në fuqi, pasi që zbatimi i saj ka filluar me datë 11.06.2018, ndërsa përfundimisht ka përfunduar se zbatuari me datë 10.06.2021.

Pra, e drejta për pagën e 13 (trembëdhjetë) për vitin 2021, do mund të kërkohej në muajin janar të vitit 2022, e po ashtu ajo e vitit 2022, do mund të kërkohej në muajin Janar 2023, andaj në këtë rast marrë parasysh përfundimin e zbatimit të Kontratës Kolektive Sektoriale të Shëndetësisë të datës 12.06.2018, kjo gjykatë erdhi në përfundim se kërkesëpadia lidhur me kompensimin e pagës se 13 (trembëdhjetë) për vitin 2021 dhe 2022 nuk ka mbështetje në dispozitë ligjore materiale.

Sa i përket kërkesës së paditëses për pagesën e shujtave ditore, gjykata gjen se kërkesa e paditëses mbështetet në Deklaratën e Përbashkët të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Federatës Sindikale të Shëndetësisë së Kosovës të datës 14.10.2008. Nga vlerësimi i kësaj deklarate, gjykata konstaton se kjo deklaratë nuk ka fuqinë e aktit ligjor apo nënligjor dhe nuk paraqet dokument detyrues për të paditurën. Kjo nënkupton se, pavarësisht marrëveshjes mes palëve të përfshira, Deklarata nuk ka kaluar procesin e nevojshëm të miratimit ligjor dhe për këtë arsye nuk mund të përdoret si një dokument ligjërish detyrues. Gjykata, duke vlerësuar bazën juridike të kësaj pjese të kërkesëpadisë, konstaton se çdo pretendim për kompensim duhet të mbështetet në një bazë të vlefshme juridike, dhe së këndejmi e paditura nuk mund të detyrohet të përmbushë një kërkesë mbi bazën e një deklarate që nuk ka peshën e një akti ligjor apo nënligjor të miratuar sipas procedurës përkatëse. Për më tepër Ligji për pagat në sektorin publik në nenin 30 [Shtesa për nëpunësen/in e sistemit shëndetësor] dhe në nenin 33 [Shtesa funksionale për nëpunësen/in e sistemit shëndetësor] ka përcaktuar shtesat për nëpunësit e sistemit shëndetësor dhe, njëkohësisht ka përcaktuar edhe kushtet për përfitimin e këtyre shtesave, e që për pasojë, gjykata ka konstatuar se shtesa e pretenduar për shujta nuk hyn në kategorinë e këtyre shtesave.

Gjykata ka vlerësuar pretendimin e paditëses se me aktgjykimin e Gjykatës Kushtetuese është shpallur i pavlefshëm paragrafi 2, 3 dhe 4 i nenit 41 (shtesa tranzitore) dhe paragrafi 2 i nenit 45 (shfuqizimi) i Ligjit për pagat në sektorin publik dhe mbi këtë bazë paditëses i takon e drejta në kompensim të shujtës ditore. Megjithatë, duke qenë se kërkesa e paditëses nuk mbështetet në një akt ligjor apo nënligjor por në një deklaratë e cila për arsyet që u elaboruan më lartë, u konstatua se nuk prodhon efekte juridike gjykata një pretendim të tillë e vlerëson si të pabazuar.

Gjykata vendosi që këtë çështje kontestimore ta vendos jashtë seancës gjyqësore duke u mbështetur në nenin 399 të LPK-së, e cila parasheh që *“Kur gjykata, pasi t’i arrijë përgjigja në padi, konstaton se nga faktet e treguara në padi nuk del themelësia e kërkesëpadisë, atëherë ajo do te jep vendimin meritor me të cilin refuzohet si e pathemeltë kërkesëpadia”*, si dhe duke u bazuar në praktikën e ndërtuar nga Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut (rasti Jussia kundër Finlandës, nr.73053/01), e cila praktikë është obligim që të zbatohet nga Institucionet e Republikës së Kosovës, obligim i cili del nga neni 53 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, i cili parasheh se *“Të drejtat njeriut dhe liritë themelore të garantuara me këtë Kushtetutë, interpretohen në harmoni me vendimet gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut”*.

Vendimin që secila palë ti bartë shpenzimet e veta të procedurës, gjykata e mori duke u bazuar në nenin 450, 452 dhe 463 të LPK-së.

Nga sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË

Departamenti i Përgjithshëm

C.nr.3600/23, me 01 nëntor 2024

Gj y q t a r j a
Blerina KURTAJ

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij aktgjykimi mund të ushtrohet ankesë në afat prej 7 ditësh, nga dita e marrjes së aktgjykimit, Gjykatës së Apelit të Kosovës në Prishtinë e nëpërmes kësaj Gjykate. Ankesa duhet të paraqitet në kopje të mjaftueshme për palët dhe gjykatën.